



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-037  
Prishtinë, më 19 korrik 2018, në orën 15:30  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 19 KORRIK 2018**

**Në mbledhje morën pjesë:** Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, Xhavit Haliti, Aida Dërguti dhe Slavko Simiq.

**Nga grupet parlamentare:** Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Liburn Aliu, Visar Ymeri dhe Ahmet Isufi.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit:** Avni Bytyçi.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj.

Mbledhjen e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, i zhvilloi punimet me këtë:

#### Rend dite

1. Caktimi i datës për mbajtjen e seancës plenare

\*\*\*

### **1. Caktimi i datës për mbajtjen e seancës plenare**

Kryetari i njoftoi të pranishmit se seanca plenare, e filluar më 19 korrik 2018, nuk e ka përfunduar asnjë pikë të rendit të ditës.

Ai propozoi që të hënën, më 23 korrik 2018, Kuvendi t'i vazhdojë punimet me pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme dhe me seancën e re plenare.

Kryesia, me propozim të përfaqësuesit të GP-të PSD-së, deputetit Visar Ymeri, e hoqi nga rendi i ditës interpelancën me ministrin e Administratës Publike, z. Mahir Jagxhilar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, në lidhje me mosndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. MSHP 2004/07 për udhëtimet zyrtare.

Gjithashtu, Kryesia në rend të ditës e radhit për seancën plenare të re, më 23 korrik 2018, Debatin parlamentar për dialogun me Serbinë, të propozuar nga GP i PSD-së.

Në lidhje me caktimin e seancës plenare diskutuan: kryetari i GP të PDK-së, Memli Krasniqi dhe kryetari i GP të LDK-së, Avdullah Hoti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve, unanimisht vendosi që seanca plenare t'i vazhdojë punimet të hënën, më 23 korrik 2018, në orën 11:00, si në vijim:

### **I. Pikat e papërfunduara nga seancat plenare të mbajtura më 8, 14, 19, 28 qershor dhe më 5, 6 dhe 9 korrik 2018:**

*1. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-080 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Unionit "Konkurrenca e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME), 2014-2020",*

*2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje,*

*3. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,*

4. *Votimi i raportit vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017,*
5. *Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017,*
6. *Votimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2017,*
7. *Votimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017,*
8. *Votimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2017,*
9. *Votimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2017,*
10. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021,*
11. *Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në lidhje me vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikalo, për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione.*

## **II. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare e mbajtur më 12 dhe 13 korrik 2018:**

1. *Votimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë,*
2. *Votimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve,*
3. *Votimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës,*
4. *Votimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumentet publike,*
5. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës,*
6. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut,*
7. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/ L-009 për ndërmjetësim*
8. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/ L-010 për noterinë.*

## **III. Pikat për seancë të re plenare:**

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*

3. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-066 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shoferi,*
4. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-067 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës,*
5. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-068 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120,*
6. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-069 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor,*
7. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-070 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor,*
8. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-071 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme,*
9. *Debat parlamentar për dialogun me Serbinë,*
10. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale,*
11. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-065 për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme,*
12. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës,*
13. *Propozimi i grupeve parlamentare të AAK-së dhe Nismës Socialdemokrate për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.*
14. *Shqyrtimi i raportit vjetor i Autoritetit Rregullator për Ujëra për vitin 2017,*
15. *Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017,*
16. *Shqyrtimi i raportit vjetor për vitin 2017 i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.*

Në fund, kryetari i njoftoi të pranishmit se mbledhja e radhës e Kryesisë së Kuvendit, pa kryetarët e grupeve parlamentare, do të mbahet të hënën, më 23 korrik 2018, në orën 09:00, për t'i shqyrtuar disa pika që kanë të bëjnë vetëm për vendimmarrje të Kryesisë.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 16:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit:  
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:  
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*